



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
SHOQËRIA PËRMBARIMORE
"STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k.



Adresa: Rr. "Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 3960

Nr. 14089 Prot.

Tiranë, më 25.10.2016

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Regjistrimit



Për dijëni : Veneto Bank Sh.A.

Shoqërisë "Albdesign" Sh.p.k.

Lënda : *Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative*

Në Tiranë, sot më datë 25.10.2016,

Unë **Edvin Malotaj** përmbarues gjyqësor privat pranë shoqërisë përmbarimore "Strati Bailiff's Service" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, i pajisur me certifikatë Nr. 106, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të "Urdhërit Ekzekutimit" Nr. 5443 Regj. Them., datë 19.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se në datë 10.10.2016 është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe lidhur kontrata e shërbimit, pranë Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service" Sh.p.k., për ekzekutimin e titullit ekzekutiv Faturë Tatimore Shitjeje Nr. 14062617, dt. 10.10.2014 dhe Faturë Tatimore Shitjeje Nr. 14062748, dt. 12.11.2014 për të cilat është lëshuar urdhëri i ekzekutimit Vendimi Nr. 5443 Regj. Them., datë 19.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë;

Kreditor : Shoqëria "Albdesign" Sh.p.k.

Debitor : Veneto Bank Sh.A.

Me Objekt : *pagim fature*

Me vendimin Nr. 5443 Regj. Them., datë 19.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur:

"Pranimin e kërkesës.

Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit për titujt ekzekutiv Faturë Tatimore Shitjeje Nr. 14062617, dt. 10.10.2014 dhe Faturë Tatimore të Shitjes Nr. 14062748, dt. 12.11.2014, si dhe kamatvonesat përkatëse".


Në zbatim të këtij titulli ekzekutiv, debitori i është komunikuar shkresërisht lajmerimi për ekzekutim vullnetar me shkresën Nr. 13662 Prot., datë 10.10.2016.

Sa më sipër kur debitori nuk ka ekzekutuar titullin ekzekutiv vullnetarisht, bazuar në nenin 519, 527, 593 e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Nr.10031 datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Privat", Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë, "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në Banka" dhe Udhëzimit Nr. 1240/5, datë 15.09.2009 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat"

URDHËROJ:

- 1- Qendra Kombëtare të Regjistrimit të vendosë masën e sekuestros konservative mbi aktivet e rregjistruara pranë jush që zotëron pala debitore:
 - **"VENETO BANKA" Sh.A., me NIPT J71928004K, dhe me përfaqësues ligjor Z. Pierluigi Caferri, për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 5443 Regj.Them, datë 19.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**
- 2- Këto aktive të qëndrojnë të bllokuara deri në një urdhër të dytë.
- 3- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.
- 5- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

Përmbarues Gjyqësor Privat


Edvin Malotaj

